



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:001485

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06148054

KA.nr.447/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “D.P.T. Market Pejta” (B.B. BI) me NUI ... dhe me seli në fshatin Prevallë në Prizren, të cilin sipas prokurës e përfaqëson avokati Fisnik Sogojeva me seli në rrugën “Rexhep Luci”, hy.20 kati III nr. 11 në Prishtinë, kundër të paditurit Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 09.07.2024, në të cilën mori pjesë paditësi, ndërsa i padituri mungoi, më 2 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “D.P.T. Market Pejta” (B.B. BI) me NUI ... kundër të paditurit Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit KAHA-05/19/II të datës 27.11.2019 të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 08.01.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ fillimisht kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e aktit administrativ KSHA-05/19/II të datës 27.11.2019 të së Paditurit.
2. Ai në padi, ka deklaruar se paditësi ka pasur të ndërtuar një objekt-kiosk e regjistruar në emër të prindit të tij B.B., ndërsa inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas inspektimit e ka nxjerr vendim me nr. rendor. 05/2019 dhe numër të protokollit 19-INS-SK-23-PV-12 të datës 22.08.2019, duke e urdhëruar atë ta ndërpres menjëherë aktivitetin e vendosjes së objektit apo kioskës dhe largimin e saj nga zona e

Prevallës. Ka shtuar se pas ankesës ndaj këtij vendimi, Komisioni për shqyrtimin e ankesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marr vendim për pezullimin e aktvendimit me nr. rendor. 05/2019 dhe numër të protokollit 19-INS-SK-23-PV-12 të datës 22.08.2019, deri në shqyrtimin e çështjes nga ana e grupit punues për gjendjen e një zgjidhjeje të përkohshme për vendosjen e kioskave.

3. Sipas tij, pavarësisht kësaj i Padituri nuk e kishte përfillur vendimin dhe e kishte rrënuar kioskën, në kundërshtim me dispozitat ligjore duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm atij me pamundësimin e zhvillimit të veprimtarisë së shitjes së produkteve vendore, me çka e kanë rrezikuar edhe mbijetesën dhe të ardhurat e familjes së tij.
4. Përveç kësaj, ai ka deklaruar se që deri më tani Komisioni për gjetjen e një zgjidhjeje të përkohshme për vendosjen e kiosqeve dhe shitëseve ambulantiv ende nuk e ka përfunduar punën për të cilën është krijuar, e që nxjerrja e vendimit për rrëzimin – ndalimin e veprimtarisë afariste për atë.
5. I padituri në përgjigje e tij në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka propozuar gjykatës refuzimin e saj si të pabazuar. Ai ka deklaruar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa Paditësi nuk ka sjellë prova për vërtetimin e pretendimeve të tij.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

6. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi KSHA05/19/II i datës 27.11.2019 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave i të paditurit; aktvendimi me nr. prot. 19-INS-SK-23-PV-12 i datës 22.08.2019 i Inspektoratit të së paditurit; ankesa e paditësit e datës 04.09.2019 kundër vendimit 19-INS-SK-23-PV-12 i datës 22.08.2019; përgjigjja ndaj kërkesës, me numër të referencës 398/DAPKSH/2019 e datës 19.07.2019 e të paditurit; vendimi KSHA-05/09 i datës 11.09.2019 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave i të paditurit; shkresat e lëndës së procedurës administrative, të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi, si dhe janë shikuar 3 fotografi pa ngjyra.

7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Më 08.08.2019 Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e kishte inspektuar Paditësin dhe kishte konstatuar se Paditësi kishte qenë duke punuar në kioskën e tij, të ndërtuar në parcelën e tij në fshatin Prevallë të Prizrenit, edhe përkundër vërejtjeve të dhëna nga DPAKSH-ja. Gjithashtu, i Padituri kishte konstatuar se Paditësi ishte pajtuar që ta largoj kioskën dhe gjatë inspektimit kishte filluar ta largoj mallin. Po ashtu, I Padituri përmes procesverbalit e kishte urdhëruar Paditësin që brenda pesë ditëve ta largoj kioskën, në të kundërtën do të veproji sipas dispozitave në fuqi. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit mbi inspektimin e kryer me numër rendor nr. 19-INS-SK-23-PV-12 i datës 08.08.2019, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
9. Më 22.08.2019 i Padituri përmes aktvendimit me numër rendor 05/2019 e kishte urdhëruar Paditësin që *“1. Të ndërpres menjëherë aktivitetin e vendosjes së objektit-kiosk-market, për largimin e saj në zonën Prevallë, e vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, mbi regjimet e mbrojtjes të zonave të parkut kombëtar “Sharri”, dispozitat e nenit 3 nga Ligji nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”, dhe neni 8 e 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233. 2. Obligohet drejtoria e PK “Sharri”, që të përcjellë gjendjen në teren dhe aktivitetin e operatorit në fjalë për zbatimin e këtij aktvendimi”*. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga vendimi i sapo cekur.
10. Paditësi më 04.09.2019 kishte ushtruar ankesën kundër vendimit të cekur në paragrafin e mësipërm, duke kërkuar që marketi i tij të jetë aktiv. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes ankesës së cekur në këtë paragraf.
11. Më 23.07.2024 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e kishte dhënë vendimit 97/AMMK/2019, me të cilin e kishte themeluar një grup punës për gjetjen e në zgjidhjeje të përkohshme për vendosjen e kiosqe dhe shitësve ambulantiv në një lokacion të përshtatshëm që nuk i pengon aktivitetet në Prevallë, në përbërje prej shtatë anëtarëve. Nga vendimi i sqaruar në këtë paragraf, gjykata i vërtetoi faktet e cekura.
12. Komisioni për Shqyrtimin e ankesave më 11.09.2019 përmes vendimit KSHA-05/19 kishte vendosur që të pezullohet aktvendimi 05/2019 i datës 22.08.2019 i Inspektoratit të

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor deri në shqyrtimin e çështjes nga grupi punues i cekur më lartë. Këto fakte gjykata i gjeti përmes vendimit të sapo cekur.

13. Më 22.11.2019 i Padituri e kishte bërë rrënimin e kioskës të Paditësit. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes fotografive, deklaratës së Paditësit në padi, të cilat nuk ishin kontestuar nga i Padituri gjatë procedurës.
14. Grupi punues i themeluar me vendimin 97/AMMK/2019 të datës 23.07.2024, përmes raportit me numër të protokollit 5630/19 të datës 16.09.2019 e kishte njoftuar krye shefin ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës se “... pa aprovimin e Planit Rregullues të hollësishëm për zonën në fjalë, Komisioni e ka të pamundur që të propozoj një zgjidhje siç është kërkuar”. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes raportit të cekur në këtë paragraf, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
15. Më 25.11.2019 krye shefi ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dha vendimin me numër të protokollit 6928/19, me të cilin e shfuqizoi vendimin 97/AMMK/2019 të datës 23.07.2024, me arsyetimin se grupi punues nuk ka mundur të jep përgjigje meritore e cila do të kënaqte kërkesat e operatorëve dhe bazën ligjore që e rregullon këtë çështje, si pasoj e mungesës së Planeve Rregulluese të Hollësishme. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
16. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave më 27.11.2019 përmes vendimit KSHA-05/19/II e shfuqizoi vendimin KSHA-05/19 të datës 11.09.2019 për pezullimin e procedurës, e vërtetoi vendimin e goditur me ankesën nr. 05/2019 të datës 28.08.2019 të shkallës së parë, si dhe e refuzoi ankesën e Paditësit. Komisioni kishte arsyetuar se, shkalla e parë ka vepruar në përputhje me nenin 24 para. 1.2 të ligjit 04/L175, nenit 3 të ligjit 04/L-087, si dhe nenit 8 dhe 11 të ligjit nr. 03/L-233. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
17. Për gjykatën është fakt i njohur botërisht se fshati Prevallë është pjesë e zonës së mbrojtur në kuadër të parkut kombëtar “Sharri”, sipas Ligjit 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri” (këtu e tutje LPKSh).

III. Vlerësimi meritor i rastit

18. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në

përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht duhet të refuzohet.

19. Në rend të parë, gjykata gjeti se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Gjkata gjithashtu gjen se vendimi i goditur është në harmoni me neni 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, si dhe i Padituri ka qenë kompetent për dhënien e aktit administrativ të goditur. Gjkata vëren se Paditësi nuk kishte pretendime të kësaj natyre.
20. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjkata rikujton se, i Padituri kishte konstatuar se Paditësi pa leje përkatëse e kishte ndërtuar/vendosur një kioskë në pronën e vet dhe po zhvillonte aktivitet ekonomik në atë. Paditësi nuk e ka paraqitur asnjë provë, nga e cila do të rezultonte se ai ka pasur leje për ndërtimin ose vendosjen e asaj kioske dhe zhvillimin e aktivitetit ekonomik në zonën e mbrojtur të parkut kombëtar “Sharri”, ndonëse sipas nenit 322 para. 2 të LKA-së ai e ka pasur barrën e provës. Prandaj, gjykata vlerëson se gjendja faktike e vërtetuar nga i Padituri është e njëjta me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata.
21. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Sipas nenit 24 para. 2 të Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (këtu e tutje LMUNPHN) *“Për mënjanimin e parregullsive të konstatuara, inspektori ka të drejtë dhe detyrim që subjektin e mbikëqyrjes: (...) 1.2. ta urdhërojë ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve përkatëse në afatin të cilin do ta përcaktojë inspektori”*. Nga ky nen rrjedh autorizimi i inspektoratit të së Paditurit që ta detyroj Paditësin që ta ndërpres vendosjen e kioskës dhe largimin e saj, meqenëse nuk ka pasur leje për një gjë të tillë.
22. Gjkata e sheh të arsyeshme të sqaroj se, edhe pse i Padituri e kishte rrënuar kioskën e Paditësit para se të nxirret vendimi i goditur, megjithatë për lëndën konkrete kjo çështje nuk është me relevancë. Zhvillimi i atij aktivitetit ka paraqitur akt administrativ real, siç është paraparë me nenin 69 para. 1 i LPPA-së, ndaj të cilit pala ka pasur të drejtën e kundërshtimit sipas nenit 136 të LPPA-së. Meqenëse kundërshtimi zgjidhet nga njësia apo trupa kolegjiale me një akt administrativ, atëherë pala do të kishte pasur të drejtë ankese ndaj vendimit mbi zgjidhjen e kundërshtimit varësisht nga ekzistimi i organit

epror ose të drejtën e paraqitjes së padisë, nëse nuk ka pasur organ eprror. Nga kjo rrjedhë se, meqenëse në këtë procedurë objekt është shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrativ përfundimtar KSHA-05/19/II i datës 27.11.2019 i të Paditurit, atëherë gjykata nuk mundet të shqyrtoj edhe ligjshmërinë e aktit real për ekzekutimin e vendimit të shkallës së parë.

23. Prandaj, meqenëse procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se akti administrativ i goditur është dhënë në përputhje me nenet 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga nenit 52 i LPPA ose nenit 16 i LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e aktit administrativ të goditur.
24. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata duke u bazuar në nenet 13, para. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.447/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.